



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHKETËSE
DREJTORIA E FINANCES BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 18798 prot.

Vlorë, më 17.09 2026

PROJEKTVENDIM
Nr. _____, Datë _____.2026

“PËR NJË RISHIKIM NË VKB NR.100, DT.23.12.2025
“PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026” i ndryshuar

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e tij të datës . ,2026 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e Buxhetit Shtesë të Bashkisë Vlorë për vitin 2026, mbështetur në:

Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c; Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësisë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 65. Udhëzimi i MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 28.02.2025 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028” Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (plotësues) nr.19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”

Akti Normativ nr.11.19.12.2025 “Per transferimin e pakushtezuar te pergjithshme “ per vitin 2025” V.K.B Nr. 98, datë 27.11.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksionet e deleguara -2026”. V.K.B Nr. 96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” i ndryshuar, shprehur i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 12.12.2023. V.K.B nr.100 datë 23.12.2025 Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026”.

VENDOSI:

- ## Për nevoja të Bashkisë për sa më poshtë :

	Pakesime		Viti	Viti
	Bashkia Vlore Programi(1110) artikulli 231 Investime	000/mije leke	2026	2027
1	Rikonstruksioni I Rruges Agjah Libohova	-22.850	-22.850	
	Totali I Pakesimit	-22.850	-22.850	
	Shtesa		Viti	Viti
	Bashkia Vlore Programi(01110) artikulli 231 Investime	000/mije leke	2026	2027
1	Rindertimi I mureve rrethues, pergjate projektit per rikonstruksionin e rrugeve " Myslym Gjoleka""Ahmet Lepenica" Hysni Muka" ne lagjen "Kushtrimi" Vlore	28.419	22.850	5.569

Objekti; Rindertimi I mureve rrethues, pergjate projektit per rikonstruksionin e rrugeve " Myslym Gjoleka""Ahmet Lepenica" Hysni Muka" ne lagjen "Kushtrimi" Vlore

Preventiv

[illegible]

2. Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.02.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCES BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 18798 prot.

Vlorë, më 17. 09 2026

RELACION

**“PËR NJË RISHIKIM NË VKB NR.100, DT.23.12.2025
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026”, i ndryshuar**

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë!

Ligji 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi. Ligji zbatohet nga njësitë e Qeverisjes Qëndrore dhe Vendore në të gjitha fazat e procesit buxhetor si përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi në Këshill, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i buxhetit, të drejtat dhe kufizimet që përcakton ligji, garancitë, si dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre, kontrolli, kontabiliteti, raportimi, inspektimi dhe auditimi i buxhetit.

Nga sa më lartë, Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe administrata nën drejtimin e tij, kanë hartuar projektvendimin “Për një rishikim në V.K.B nr.100, date 23.12.2025, bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, nenet: 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c; Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44, buxhetit”.

1. Ndryshime në zërin investime të miratuara në VKB nr 100 datë 23.12.2025 “ Për buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2026” i ndryshuar.Për nevoja të Bashkisë për sa më poshtë :

<i>Pakesime</i>			Viti	Viti
	Bashkia Vlore Programi(1110) artikulli 231 Investime	000/mije leke	2026	2027
1	Rikonstruksioni I Rruges Agjah Libohova	-22.850	-22.850	
	Totali I Pakesimit	-22.850	-22.850	
<i>Shtesa</i>			Viti	Viti
	Bashkia Vlore Programi(01110) artikulli 231 Investime	000/mije leke	2026	2027
1	Rindertimi I mureve rrethues, pergjate projektit per rikonstruksionin e rrugeve " Myslym Gjoleka"" Ahmet Lepenica" Hysni Muka" ne lagjen "Kushtrimi" Vlore	28.419	22.850	5.569

Gjatë verifikimit në terren dhe në vijim të zbatimit të projektit të furnizimit me ujë në rrugën “Agja Libohova”, është konstatuar se kanali ekzistues i shkarkimit të ujërave të shiut ndodhet në një distancë nga gjurma e parashikuar në projekt.

Për këtë arsye, gjurma fillestare e projektit nuk mund të realizohet sipas parashikimit fillestar, pasi nuk siguron lidhjen e nevojshme me pikën ekzistuese të shkarkimit të ujërave të shiut. Në këto kushte, lind nevoja për zgjerimin/ndryshimin e gjurmës së projektit, duke përcaktuar një gjurmë të re që mundëson realizimin e plotë të linjës deri në pikën e shkarkimit.

Ndryshimi i gjurmës sjell edhe shtesë të volumit të punimeve dhe të fondit, pasi duhet të realizohet e gjithë linja e re e kanalizimit, duke përfshirë segmentin nga gjurma e parashikuar fillimisht në projekt deri në pikën e re të shkarkimit.!

Ne te tilla kushte e shohim te arsyeshme qe deri ne realizimin e plote te projektit te ri per ti dhene zgjidhje teknike problematikes se lindur fondet e percaktuara per kete rruge te perdoren ne objektin :Mure rrethues ne lagjen Kushtrimi:

Kërkesa për shtimin e fondeve për realizimin e punimeve të ndërtimit të rrugëve në Lagjen Kushtrimi lidhet me nevojën për sistemimin dhe unifikimin e mureve rrethuese të pronave private përgjatë gjurmës së rrugës.

Nga verifikimi i gjendjes ekzistuese rezulton se muret rrethuese aktuale paraqiten me lartësi, dimensione, materiale dhe tipologji të ndryshme ndërtimore, duke krijuar një pamje jo të unifikuar dhe duke ndikuar në standardizimin e elementeve të trajtimit të hapësirës përgjatë rrugës.Për garantimin e një zgjidhjeje të unifikuar urbanistike dhe konstruktive, si dhe për përmirësimin e parametrave teknikë dhe estetikë të segmentit rrugor, është parashikuar prishja e mureve rrethuese ekzistuese dhe rindertimi i tyre sipas një tipologjie dhe standardi të unifikuar ndërtimi.Këto punime përfshijnë ndërhyrjet e nevojshme për germimin e dheut per themele, përgatitjen e bazamentit dhe ndërtimin e mureve të reja rrethuese, në përputhje me parametrat teknikë të përcaktuar në projekt.

Përfshirja e këtyre punimeve sjell një volum shtesë pune dhe, për rrjedhojë, një rritje të kostos së parashikuar fillimisht për realizimin e investimit. Shtimi i fondit konsiderohet i nevojshëm për përfshirjen e plotë të këtyre ndërhyrjeve dhe për realizimin e një zgjidhjeje përfundimtare të standardizuar dhe funksionale të infrastrukturës rrugore në Lagjen Kushtrimi.

Ne keto kushte volumet e llogaritura per ndertimin e murreve rrethues e tejkalojne vleren e parashikuar ne projektin fillestar ne masen 28 085 149.24 leke me TVSH (si difference e preventivit total 39 132 899.89 leke me vleren e projektit fillestar 11 047 750.65 leke), pasi per realizimin e projektit jane prishur me teper mure rethues te cilat duhet te rindertohen sipas projektit te miratuar

Objekti; Rindertimi I mureve rrethues, pergjate projektit per rikonstruksimin e rrugeve " Myslym Gjoleka""Ahmet Lepenica" Hysni Muka" ne lagjen "Kushtrimi" Vlore

Preventiv (shitesa)

NR	KODI	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1. PUNIME DHEU						
1	2.26a	Germim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne auto >	m3	303.0	222.16	67,314.48
Shuma 1:						67,314.48
2. PUNIME BETONI DHE B/A						
2	2.201	Themel betoni C16/20 >	m3	318.0	15,972.29	5,079,188.22
3	2.130/1a	Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 >	m3	364.0	20,911.92	7,611,938.88
4	2.117/1a	Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m >	m3	19.0	38,139.03	724,641.57
Shuma 2:						13,415,768.67
3. PUNIME HEKUR BETONI						
5	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >	ton	11.3	145,357.76	1,642,542.69
6	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm >	ton	4.7	135,444.75	636,590.33
7	2.182	F.V. Konstrukione metalike te thjeshta. >	ton	25.72	156,021.61	4,012,875.81
Shuma 3:						6,292,008.82
4. PUNIME BOJATISJE						
8	2.401	Boje vaji siperfaqe metalik >	m2	2400.0	1,158.47	2,780,328.00
Shuma 4:						2,780,328.00
Shuma Analiza						22,555,419.97
Fondi Rezervë (5.0%)						1,127,771.00
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						23,683,190.97
TVSH (20%)						4,736,638.19
Shuma me TVSH						28,419,829.16
Totali						28,419,829.16

2. Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.02.2015, neni 55, pika 6

DREJTOR

Hiqmet Haxhaj